There are no translations available.

Në zbatim të nenit 43, të Statutit të BSPSH-së, në ditën e dytë të Kongresit, në datën 7 Shtator 2014, u mbajt mbledhja e parë e zgjeruar e Asamblesë Kombëtare ku morën pjesë dhe drejtuesit e seksioneve më aktive të BSPSH në ambientet e Hotel “ Tropikal” në Durrës. Presidenti i BSPSH-së prezantoi konstituimin dhe përbërjen e organeve vendimmarrëse të Asamblesë, të Këshillit Kombëtar, të Komisionit të Interpretimit dhe Zbatimit të Statutit dhe të Komisionit të kontrollit financiar. Punimet e Asamblesë, bazuar në Statutitin e BSPSH-së, u drejtuan nga Presidenti, nga drejtuesi i federatës më të përfaqësuar dhe drejtuesi i rajonit më të përfaqësuar. Në vijim u bë zgjedhja e komisionit të përhershëm të votimit të Asamblesë Kombëtare, me 3 anëtarë. Në zbatim të nenit 13 të Statutit, Presidenti prezantoi përbërjen e Asamblesë së re Kombëtare, me pjesëmarrjen e 101 anëtarëve, ku 45 mandate janë për federatat, 45 mandate janë për rajonet dhe 11 për organet qëndrore të BSPSH-së. Më pas Asambleja Kombëtare, bazuar në nenin 15, 25 dhe 36, të Statutit të BSPSH-së miratoi konstituimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të BSPSH-së, si më poshtë:





